QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINE DHE ZHVILLIMIN
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT

**LËNDA: FTESË PËR OFERTË PËR BLERJE PRODUKTESH DHE SHËRBIMESH**

Të nderuar,

Nëpërmjet kësaj letre, ju ftojmë të paraqesni ofertën tuaj lidhur me punimet elektrike të ndriçimit të zyrave së QShPZh dhe Qendrës PO që do të zhvillohet nga organizata Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QShPZh).

## Informacion i përgjithshëm rreth QShPZh

QShPZh-ja është një organizatë jo fitimprurëse, e themeluar në Janar të vitit 1993, e cila punon për përmirësimin e politikave, legjislacionit, të drejtën për informacion dhe shërbime për cështje që shqetësojnë popullatën dhe zhvillimin e saj, përfshirë shëndetin riprodhues.

Qendra PO, krahas zhvillimit të aktiviteteve te ndryshme për të rinjtë në ambjentet e saj, disponon edhe ambjente klinike ne te cilat ofron edhe shërbime mjeksërore të shëndetit riprodhues të tilla si ekografi, ekzaminime gjinekologhike, këshillime psiko – sociale etj. Në këto rrethana është parë e domosdoshme ndryshimi i pajisjeve të ndriçimit për të lehtësuar proçesin e punës të stafit programatik dhe mjekësor gjatë ditëve të punës

# TERMA REFERENCE

### 1. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Synimi i përgjithshëm është ndriçimi i zyrave të QShPZh dhe Qendrës PO për të siguruar mbarëvajtjen dhe punën e stafit.

QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINE DHE ZHVILLIMIN
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT

**Objekti**

- Blerja e produkteve dhe shërbimeve të kërkuara janë sipas listës në vijim:

| Nr | Përshkrimi | Njësia matëse | Sasia e parashikuar | Çmimi /njësi (ALL) | Vlera (ALL) |
|---|---|---|---|---|---|
| **1** | F.V Panel Led 33Ë 4000K 600x600 | Copë | 22 | 8000 | 176,000 |
| **2** | F.V Spot rrethor LED inkaso 18Ë | Copë | 1 | 1500 | 1500 |
| **3** | F.V Detektor lëvizje 360h=2.8/8m IP40 | Copë | 2 | 4000 | 8000 |
| **4** | F.V Ndriçues Plafon 42Ë 3000K | Copë | 2 | 27000 | 54000 |
| **5** | Materiale të imta ( tub fleks+tub rigid+nastro+grapeta) | Copë | 4 | 3000 | 12000 |

## 2. Data dhe Vendi

Me kërkesë të organizatës, ofertat e produkteve dhe shërbimeve do të dorëzohen në Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin adresa: Bulevardi "Gjegj Fishta", Nd.26, H.6, Ap.5, 1001, Tiranë. Tel: +042251475, brenda orës 16:30.

## 3. Profili i kërkuar i aplikantit

1. Subjekt tregtari i regjistruar konform legjislacionit shqiptar në fuqi.

## 4. Përzgjedhja dhe Tarifat

Operatori ekonomik i cili do të përzgjidhet për ofrimin e shërbimit të lartë përmendur, do ti kryhet pagesa pas dorëzimit të produkteve dhe shërbimeve dhe faturës përkatëse në llogarinë bankare të subjektit.

## 5. Aplikimi

Ju ftojmë të shprehni interesin tuaj duke dërguar aplikimet tuaja me postë ose dorazi në adresën (adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nd.26, H.6, Ap.5, 1001, Tiranë).

Dokumentat e aplikantit si më poshtë:

- NIPT, Ekstrakt historik
- Oferta Financiare përfshirë TVSH për shërbimin që kërkohet.

**Vlerësimi i ofertave:**

Të gjithë ofruesit do të vlerësohen për ofertën më të ulët financiare.

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QShPZh), inkurajon çdo ofrues shërbimi të mundshëm të shmangë dhe të parandalojë konfliktet e interesit.

*Për cdo pyetje, ju lutem mos ngurroni ti adresoni në adresën e email: info@acpd.org.al*